


REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	<u>2-D/DPK</u>
Dep.	
Nr. I faq.	
Broj stranica	<u>02</u>
Nr. pages	
Nr. Prot.	<u>01-4820/14</u>
Br.Prot	
Prot No.	
Data	
Datum	<u>16.12.2014</u>
Date	
PRISHTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.12.2014, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-4259-14 për z.Xhelal Selmani** – Drejtor Bordi në Kompaninë Rajonale të Ujit “Hidromorova” Gjilan, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-4259-14, për Zyrtarin e lartë, z.Xhelal Selmani–Drejtor Bordi në Kompaninë Rajonale të Ujit “Hidromorova” Gjilan dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z.Selmani fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D./DPK-01-4469-14), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Selmani është deklaruar se shumë shpejt do t'i bëjë këto ndryshime, për të cilat nuk ka qenë në dijeni se duhet të bëhen.

Ndërkohë, z.Selmani, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë një shkresë zyrtare (DPK/DPKI-03-4737/14) bashkë me “Informata mbi biznesin” nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se ai ka heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat Ndërrmarrja për Inxhinering dhe Tregti “Metalmont”, duke emruar në këtë pozitë një person të besuar.

Tani, z.Selmani, ushtron vetëm funksionin e tij publik; Drejtor i Bordit në K.R.U. "Hidromorova" në Gjilan.

**II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit  
Hasan Preteni

